



VENDIM

Nr. 161, Datë 06.10.2016

MBI

**MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY”
SH.P.K ME NR.3, SERIA.PVO3K, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT
TE KOMISIONEREVE NR. 69, DATË 12.12.2007**

Në mbështetje të neneve 16; 43 pika 1, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; VKM nr. 930, datë 02.09.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet ministrisë së ekonomisë, tregtisë dhe energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegei”, s.p.a, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhenien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” miratuar me Vendimin nr. 109, datë 29.06.2016 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E); pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 06.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut, për modifikimin e licensës së shoqërisë “Balkan Green Energy”,

Konstatoi se:

- Shoqëria FAVINA sh.p.k në cilësinë e pronarit të Hec “Voskopojë” i është drejtuar ERE me shkresën nr. 100 Prot., datë 21.01.2016, duke kërkuar rritjen e fuqisë së instaluar të këtij hec-i.
- ERE pas verifikimeve të bëra, konstaton se mbështetur në vendimin nr. 69, datë 12.12.2007, të Bordit të Komisionereve të ERE, është shoqëria koncesionare “Balkan Green Energy” sh.p.k e licencuar për të ushtruar aktivitetin e prodhimit nga HEC-“Voskopoja”.
- ERE me shkresën nr. 101/1 Prot., date 20.04.2016, i është drejtuar MEI-t, në lidhje me saktësimin e pronësisë së Hec “Voskopojë”.
- MEI është përgjigjur me shkresën nr. 2810/1, date 23.05.2016, përmes së cilës i ka kërkuar ERE-s, zbatimin e marrëveshjes së koncesionit në përputhje me VKM Nr.930 datë 02.09.2009.

- VKM Nr. 930 datë 02.09.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet ministrisë së ekonomisë, tregtisë dhe energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegei”, s.p.a, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave ka hequr nga lista e HEC-eve për të cilat është licencuar Shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. hec-et: “Piqeras”, “Lozhan” dhe “Voskopojë” në zbatim të nenit 5 i cili përcakton se: “Trajtimi i hidrocentraleve Piqeras, Lozhan dhe Voskopojë, do të merren në dorëzim dhe do të trajtohen nga Organi Shtetëror i Autorizuar.”
- Neni 43 pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikon se: ERE mund të modifikojë licencën, me iniciativën e vetë, kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesionare.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licensën me numër Nr.3, Seria PV03K, dhënë shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k, me Vendim të Bordit të ERE-s Nr.69, dt.12.12.2007, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 930, datë 02.09.2009. (Tabela me ndryshimet bashkelidhur)
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë si dhe shoqërinë Balkan Green Energy sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI

Hec "Bulqize" me fuqi 0,6 MW (Diber)
Hec "Homesh" me fuqi 0,395 MW (Diber)
Hec "Zerqan" me fuqi 0,625 MW (Diber)
Hec "Arras" me fuqi 4,8 MW (Diber)
Hec "Orgjost" me fuqi 1,2 MË (Kukes)
Hec "Lekbibaj" me fuqi 1,4 MW (Tropoje)
Hec "Dukagjin" me fuqi 0,64 MW (Shkoder)
Hec "Marjan" me fuqi 0,2 MW (Korce)
Hec "Barmash" me fuqi 0,83 MW (Kolonje)
Hec "Treske 2" me fuqi 0,25 MW (Korce)
Hec "Nikolice" me fuqi 0,7 MW (Korce)
Hec "Funares" me fuqi 1,92 MW (Librazhd)
Hec "Lunik" me fuqi 0,2 M MW (Librazhd)
Hec "Kerpice" me fuqi 0,42 MW (Gramsh)
Hec "Ujanik" me fuqi 0,63 MW (Skrapar)
Hec "Borsh" me fuqi 0,25 MW (Sarande)
Hec "Leshnice" me fuqi 0,38 MW (Sarande)
Hec "Velcan" me fuqi 1,2 MW (Korce)
Hec "Muhur" me fuqi 0,25 MW (Diber)
Hec "Rajan" me fuqi 1,02 MW (Kolonje)
Hec "Shoshan" me fuqi 3 MW (Tropoje)
Hec "Lure" me fuqi 0,75MW (Diber)